



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.249/7 prot.

Tiranë, më 27.06.2023

REKOMANDIM

Nr. 33, datë 27.06.2023

PËR KONTROLLUESIN “QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Qendra e Shërbimeve Arsimore” (në vijim, “Kontrolluesi ose QSHA”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 14, datë 30.01.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit QSHA, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale për sistemin SMIP, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. QSHA është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqytjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve. QSHA ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit, krijimin e bazës shtetërore të të dhënave për kandidatët e

regjistruar në Provimin e Shtetit, administrimin e bazës së të dhënave për arsimin parauniversitar, etj. Gjatë ushtrimit të aktivitetit, QSHA përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve *“punonjës, kandidatë për punë, vizitorë, nxënës, prindër/kujdestar ligjor, etj.”*

2. Nga verifikimi i kryer, rezulton se Kontrolluesi disponon midis të tjerave, Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (në vijim, *“SMIP”*).

Referuar komunikimit shkresor me nr. 2363/1 prot., datë 25.11.2015 të AKSHI-t, drejtuar QSHA, rezulton se SMIP është regjistruar pranë Autoritetit Rregullator Kombëtar (në vijim, *“ARK”*), në emër të QSHA, me numër identifikues 09-01-003, ku si bazë ligjore për krijimin e tij është referuar ligji nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”* (në vijim, *“Ligji nr. 69/2012”*). Nga shqyrtimi i këtij ligji, rezulton se nuk identifikohet një dispozitë ligjore konkrete, e cila parashikon ngritjen dhe funksionimin e sistemit SMIP, si dhe përcaktimin e institucionit përgjegjës për këtë sistem.

Nga ana tjetër, rezulton se baza e të dhënave SMIP është e krijuar me VKM nr. 742, datë 03.12.2021 *“Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar”* (në vijim, *“VKM nr. 742/2021”*).

Sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka vijuar me regjistrimin e ndryshimeve në përbërjen e të dhënave të mbledhura, në kundërshtim me dispozitat e VKM-së nr. 945/2012 *“Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”*”, ku në pikën 1, të nenit 9, parashikohet se: *“Regjistrimi i bazës së të dhënave shtetërore ose regjistrimi i ndryshimeve në përbërjen e të dhënave të mbledhura në bazën e të dhënave shtetërore, duhet të kryhet pranë ARK-së, brenda 20 ditëve nga hyrja në fuqi e legjislacionit përkatës për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore”*. Regjistrimi i ndryshimeve të bazës së të dhënave, është i nevojshëm për standardizimin dhe sigurinë e saj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përditësimi i ndryshimeve për bazat e të dhënave të regjistruara, sipas ligjit nr.10325/2010, duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e VKM nr. 945/2012, pasi përditësimi i bazës së të dhënave është i nevojshëm për standardizimin dhe sigurinë teknike të funksionimit të saj, me qëllim përcaktimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve, të parashikuara në nenin 27 të Ligjit.

Referuar kontratës me nr. 565 prot., datë 04.02.2019, me objekt: *“Përmirësimi i SMIP”*, si dhe konstatimeve në vend, rezulton se SMIP është i hostuar në ambientet e AKSHI-t dhe aksesohet nga përdoruesit, nëpërmjet faqes së internetit www.smip.al dhe/ose nëpërmjet *“Play Store”* (për pajisjet me sistem operativ Android) dhe *“App Store”* (për pajisjet me sistem operativ IOS), me emrin SMIP.

Përdoruesit e SMIP mund të logohen përmes llogarisë personale në portalin “*e-Albania*” dhe më pas, në mënyrë automatike, aksesojnë llogarinë e tyre në këtë sistem. Gjithashtu, përdoruesit mund të aksesojnë ndërfaqen e përdoruesit në portalin www.smip.al (sipas nivelit të aksesimit), dhe të caktojnë një “*fjalëkalim*”, në rast se dëshirojnë të aksesojnë SMIP në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet portalit www.smip.al, pasi kanë krijuar llogarinë e tij në SMIP, nëpërmjet [e-albania](http://e-albania.com).

Konstatohet që procesi i “*login/identifikimit*” nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, është i vlefshëm, si për punonjësit administrativ, po ashtu edhe për subjektet e të dhënave “*prindër/kujdestar ligjor*”. Nga verifikimi i përdoruesve administrativë, në modulën “*punonjësit*”, rezulton se numri total i përdoruesve është 33901. Punonjësve administrativë, të cilët largohen nga pozicioni i punës, u çaktivizohen atributet respektive, me kërkesë nga njësitë përgjegjëse.

Të dhënat e bazës shtetërore SMIP ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) të dhënat parësore të SMIP, konsiderohen të dhënat e mbledhura nga QSHA-ja, që kanë të bëjnë me:

- i. të dhënat e institucionit arsimor parauniversitar;
- ii. të dhënat për kontratat e punës së mësuesve dhe nivelin e kualifikimit të tyre;
- iii. të dhënat për kurrikulat në arsimin parauniversitar;
- iv. të dhënat për numrin e institucioneve arsimore parauniversitare të nxënësve dhe të mësuesve.

b) të dhënat dytësore të SMIP, merren nëpërmjet ndërveprimit me web-service, nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (në vijim, “*RKGJC*”), si vijon:

- i. numri i identifikimit personal;
- ii. emri, atësia, mbiemri;
- iii. datëlindja, vendlindja.

Dhënës të informacionit për SMIP, janë institucionet arsimore parauniversitare, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Referuar germave “*a*” dhe “*b*” të pikës 3, të VKM nr. 742/2021, baza e të dhënave shtetërore SMIP ndërvepron me RKGJC, për të marrë të dhëna dytësore, në kuptim të ligjit nr. 10 325/2010. Gjithashtu, referuar kontratës nr. 565 prot., datë 04.02.2019, si dhe konstatimeve në vend, rezulton se SMIP ndërvepron me RKGJC dhe portalin “*e-Albania*”.

Në Udhëzimin e përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 “*Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin*”, (në vijim, “*Udhëzimi nr. 463*”) të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është parashikuar lista e

institucioneve të cilat mund të marrin të dhëna personale nga shërbimi i Gjendjes Civile, për shkak të autorizimit të këtij ndërveprimi nga një dispozitë ligjore konkrete. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtij Udhëzimi, rezulton se QSHA nuk renditet në listën e autoriteteve që marrin informacion nga RKGJC.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, institucionet, organet, personat juridikë publikë (kontrolluesit publikë), mund të marrin të dhëna personale nga RKGJC, nëse kjo e drejtë njihet me ligj të veçantë. Mënyra, lloji dhe sasia e informacionit që mund të marrin, përcaktohet në Aneksin 1, të Udhëzimit të sipërcituar. Gjithashtu, në pikën 4, të Udhëzimit nr. 463, përcaktohet se: *“Për marrjen e informacionit në rrugë elektronike, kriteret dhe kushtet përcaktohen në marrëveshjen dypalëshe midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Kontrolluesit përkatës, dhe/ose sipas parashikimeve të tjera të legjislacionit në fuqi”*.

Sa më sipër, Kontrolluesi duhet të marrë masa dhe të ndjekë procedurën e parashikuar në Udhëzimin nr. 463 për përfshirjen e tij, në Aneksin 1 të këtij Udhëzimi.

Identifikimi i përdoruesve administrativë, në sistemin SMIP, kryhet përmes llogarisë së krijuar paraprakisht në *“e-Albania”*, në modulën *“qytetar”*. Të dhënat që lejojnë një përdorues të hyjë në sistem janë: *“NID”* dhe *“fjalëkalimi”* i llogarisë personale në portalin *“e-Albania”*.

Përdoruesit administrativë të sistemit mund të logohen sipas modelit *“Single Sign-On”* (SSO), nëpërmjet llogarisë personale në portalin *“e-Albania”*. Më pas, ata mund të aksesojnë ndërfaqen e SMIP, sipas nivelit të aksesimit. Konstatohet se të gjithë përdoruesit administrativë, të cilët kanë akses në SMIP, përdorin të dhënat e llogarive personale të krijuara në modulën *“qytetar”* në platformën *“e-Albania”*, të cilat i kanë krijuar për qëllime të përfitimit të shërbimeve qeveritare, në cilësinë e subjektit të të dhënave *“qytetar”*.

Në germën *“b”*, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, parashikohet se mbrojtja e të dhënave personale bazohet *“[...] në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime”*.

Sipas nenit 6 të Ligjit, të dhënat personale përpunohen vetëm: *a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;... ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit...; etj.*

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale nënkupton: *“grumbullimin, përdorimin, zbulimin, mbajtjen, ndreqjen, fshirjen, transmetimin, transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, si dhe shkatërrimin e tyre, etj.”*, që kryhen në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit në fjalë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, ndërveprimi në portalin “*e-Albania*”, me qëllim identifikimin e përdoruesve administrativë të SMIP nëpërmjet “*modulit qytetar*”, për qëllime të aksesimit të SMIP, është në kundërshtim me kërkesat dhe parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit, të cilët përcaktojnë parimet dhe kriteret ligjore për lejimin e një përpunimi të të dhënave, pasi nuk ekziston as pëlqimi i subjekteve të të dhënave për përdorimin e llogarisë personale për këtë qëllim dhe asnjë dispozitë ligjore konkrete, që të autorizojë këtë ndërveprim (*me portalin “e-Albania”*). Pra, përpunimi i të dhënave personale të modulit “*qytetar*” të punonjësve administrativë, konsiderohet jo i ligjshëm.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në zbatim të detyrimeve që parashikon Ligji, QSHA në cilësinë e Kontrolluesit të të dhënave personale, duhet të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme t’u ofrojë përdoruesve administrativë të SMIP, mundësinë e aksesimit të këtij sistemi, pa qenë nevoja e përdorimit të llogarisë personale në “*e-Albania*” nëpërmjet modulit “*qytetar*” (pra, krejtësisht në cilësinë e punonjësit administrativ të institucionit përkatës).

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet kur një sistem kryen ndërveprim me sisteme elektronike apo platforma teknologjike të tjera, që të garantohet përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të marrë masa që ky proces të plotësojë minimalisht njërin nga kriteret ligjore të përpunimit, me qëllim legjitimimin e këtij ndërveprimi.

Kontrolluesi, duhet të angazhohet për rregullimin e këtij procesi, në mënyrë që të jetë në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit, konkretisht duke ofruar një mekanizëm për autentifikimin e punonjësve administrativë, në sistemin SMIP, në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Përmbushja e detyrimeve të mësipërme nga ana e Kontrolluesit, garanton përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, në përputhje me nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Duhet theksuar që ky proces përpunimi është i vazhdueshëm dhe përfshin një sasi të konsiderueshme të dhënash personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se mosmarrja e masave nga ana e Kontrolluesit, për garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, mund të çojë në urdhërimin e bllokimit të këtij procesi përpunimi.

3. Konstatohet se niveli i aksesimit në SMIP, bazohet në rolet e krijuara të përdoruesve:
 - a. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimit;
 - b. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
 - c. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar;
 - ç. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar;
 - d. Ministria përgjegjëse për arsimin;

- dh. Ministria përgjegjëse për arsimin profesional;
- e. Qendra e Shërbimeve Arsimore ka të drejta të plota në administrimin e sistemit;
- ë. Administratori i shkollës;
- f. Mësuesi;
- g. Prindërit shohin të dhënat e fëmijës/fëmijëve së/të regjistruar në sistem si nxënës (ecurinë në shkollë).

Në SMIP, përpunohen të dhëna personale, për kategoritë e subjekteve:

- Punonjës: emër mbiemër, datëlindje, NID, vendi i lindjes, pozicioni i punës, kontakt, adresat, llogari bankare, kualifikime, promovime, informacion mbi arsimin.
- Prindër/kujdestar ligjor: emër, mbiemër, datëlindje, NID, adresë.
- Nxënës: emër, mbiemër, atësi, datëlindje, NID, vendi i lindjes, adresa, shtetësia, gjinia, minoritet, viti shkollor, vlerësimet.

Rezulton se në pikën 2, të VKM nr. 742/2021, ngarkohet QSHA si institucioni administrues i bazës së të dhënave SMIP.

Sa i përket përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet SMIP, konstatohet se QSHA gëzon cilësinë e Kontrolluesit, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 3 të Ligjit.

Sipas kontratës nr. 565 prot., datë 04.02.2019, me objekt: *“Përmirësimi i SMIP”*, lidhur midis palëve AKSHI, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, QSHA rezulton në cilësinë e përfituesit të shërbimit. Nga ana tjetër, konstatohet se SMIP nuk rezulton si aset në aktivet e QSHA-së. Sa i përket aplikacioneve SMIP, të mundësuar në platformat *“Play Store”* dhe *“App Store”*, rezulton se ato janë të zhvilluara dhe regjistruara në këto platforma, nga AKSHI.

Referuar kontratës së sipërcituar, deklarimeve të përfaqësuesve të Kontrolluesit dhe konstatimeve në vend, rezulton se QSHA është në pamundësi të demonstrojë kontrollin e plotë mbi të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet SMIP, si dhe të përcaktojë kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve nga Përpunuesit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në bazë të pikës 5, të nenit 3 të Ligjit, *“Kontrollues”*, është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, si dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Ndërsa pika 7 e nenit 3 të ligjit, përcakton se: “Përpunues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të Kontrolluesit.

Sipas këtyre përkufizimeve, cilësia e Kontrolluesit i vishet subjektit që përmbush kushtet, si vijon:

- a) Përcakton vetëm apo së bashku me të tjerë, qëllimet dhe mënyrat e përpunimit; dhe
- b) Përgjegjëset për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Ligji (parimi i përgjegjësisë, i parashikuar në pikën 2, të nenit 5 të Ligjit).

Në cilësinë e Kontrolluesit, QSHA rezulton se përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale duke përmbushur, kushtet e germës “a”, më sipër. Rrjedhimisht, QSHA ka detyrimin të demonstrojë kontrollin e plotë mbi të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet SMIP, si dhe të përgjegjëset për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Ligji (germa “b”, më sipër).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht në këtë rast, kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Sa më sipër, QSHA në cilësinë e Kontrolluesit, ka detyrimin të garantojë dhe të marrë masa mbi sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, të cilat ky Kontrollues përpunon.

4. Konstatohet se subjektet e të dhënave që vizitojnë faqen www.smip.al, nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje), etj.

Konstatohet gjithashtu se, në rubrikat informuese përkatëse të aplikacionit SMIP, në platformat “Play Store” dhe “App Store”, subjektet e të dhënave nuk informohen në lidhje me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, mbi qëllimin e përpunimit të të dhënave personale, të drejtat që këto subjekte gëzojnë, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo Kontrollues që përpunon të dhëna personale nëpërmjet faqes së internetit apo aplikacioneve, ka detyrimin që të publikojë “Politikat e Privatësisë”, me qëllim informimin paraprak të subjekteve të të dhënave, përpara se ky përpunim të fillojë. Informimi i subjekteve të të dhënave personale, është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të

dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Në këtë kuadër, publikimi i rubrikës “*Politika e Privatësisë*” në faqen zyrtare dhe aplikacionet e Kontrolluesit, përmbush më së miri qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave, të cilët aksesojnë, përdorin, ngarkojnë, etj., të dhëna personale në këto faqe apo aplikacione.

5. Konstatohet se, QSHA dhe AKSHI nuk kanë lidhur Marrëveshje Shërbimi/Kontratë për ofrimin e mirëmbajtjes dhe hostimit të SMIP, me qëllim që përpunimi i të dhënave, të kryhet vetëm në përputhje me udhëzimet e Kontrolluesit, duke përfshirë edhe delegimin drejt palëve të treta, të tillë si ofruesit e shërbimit të zhvillimit/mirëmbajtjes së sistemit.

Referuar provave dhe konstatimeve në vend, Zyra e Komisionerit vlerëson se QSHA është në gjendje të demonstrojë pozitën e tij, në cilësinë e Kontrolluesit, lidhur me SMIP, pasi pavarësisht se është e ngarkuar nga VKM nr. 742/2021 si administrator i SMIP, nga ana tjetër, rezulton se është AKSHI institucioni financues, prokurues, autoritet kontraktor, administrues dhe posedues real i infrastrukturës mbi të cilën është ngritur SMIP. Në mungesë të një marrëveshjeje midis palëve, QSHA dhe AKSHI ndodhen në kushtet e moskezistencës së një rregullimi ligjor midis tyre, për rregullimin e marrëdhënies mes palëve dhe caktimit të përgjegjësive respektive, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë tip, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojnë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me Përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të Përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që Përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e Përpunuesit për përpunim të ligjshëm të të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”).

Sa më sipër, konstatohet se QSHA nuk ka marrë masa të përshtatshme, sa i përket ushtrimit të kompetencave në cilësinë e Kontrolluesit, si dhe caktimit të detyrimeve në kontratën e shkruar me Përpunuesit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit.

6. Nga verifikimi i kryer në Regjistrin Elektronik të Subjekteve Kontrolluese dhe protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Gjatë hetimit administrativ të ushtruar, është konstatuar se “Njoftimi” ka mangësi në deklarin, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

- i. Deklarimi në rubrikën 3, të formularit të njoftimit “*kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si, por pa u kufizuar në to: “*prindër/kujdestar ligjor, vizitorë*”;
- ii. Deklarimi në rubrikën 4, të formularit të njoftimit “*kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si, por pa u kufizuar në to: “*vendlindja, vendbanimi, shtetësia, minoriteti, gjinia, vlerësimet*”;
- iii. Deklarimi në rubrikën 6, të formularit të njoftimit “*qëllimi i përpunimit*”;
- iv. Deklarimi në rubrikën 7, të formularit të njoftimit “*marrësit e të dhënave personale*”, të tilla si, por pa u kufizuar në to: “*AKSHI*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

7. Kontrolluesi disponon rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe bazës së të dhënave shtetërore*”, por konstatohet se kjo rregullore nuk parashikon qartësisht proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese që Kontrolluesi kryen.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Hartimi i një rregulloreje standarde për mbrojtjen e të dhënave personale, në të cilën mungojnë rregullat e qarta për garantimin e mbrojtjes, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, e lidhur specifikisht me veprimtarinë dhe proceset

përpunuese që kryen Kontrolluesi, nuk përmbush kërkesat e nenit 27 të Ligjit, si dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit, datë 05.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”).

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89, të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit u paraqitën në seancën dëgjimore, ku parashtruan se, qëndrimin mbi konstatimet e grupit të hetimit do t’i paraqesin me shkrim. Në vijim, me shkresën nr. 622/3 prot., datë 01.03.2023, Kontrolluesi parashtroi argumentet e përmbledhura, si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e pikës 2 të procesverbalit, QSHA ndër të tjera argumenton se: “SMIP është krijuar me VKM nr. 742/2021. Baza ligjore e krijimit të SMIP, buron nga neni 4, i ligjit 10325/2010, ku parashikohet se baza e të dhënave shtetërore mund të krijohet me ligj ose VKM. Gjithashtu, ligji 69/2012 ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuptim, të gjitha të dhënat që lidhen me të dhënat shtetërore të SMIP janë objekt i rregullimit të ligjit 69/2012.”

Lidhur me pretendimet e mësipërme të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se ato nuk qëndrojnë, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe praktikës së komunikimeve, nëpërmjet shkresës me nr.1559/3 prot., datë 19.11.2015, midis palëve, Agjencia Kombëtare e Provimeve (aktualisht QSHA), në cilësinë e administratorit të bazës së të dhënave dhe AKSHI-t, në cilësinë e Autoritetit Rregullator Kombëtar për bazat e të dhënave shtetërore, rezulton se baza e të dhënave SMIP është krijuar në një periudhë më të hershme, e cila përkon me periudhën shtator 2013. Në praktikën dokumentare të regjistrimit të bazës së të dhënave SMIP, si dhe nga pretendimet e mësipërme të Kontrolluesit, përcaktohet si bazë ligjore ligji nr. 69/2012. Nga shqyrtimi i këtij ligji, rezulton se nuk identifikohet një dispozitë konkrete, e cila të parashikojë ngritjen dhe funksionimin e sistemit SMIP, si dhe të përcaktojë institucionin përgjegjës për këtë sistem.

Lidhur me konstatimin se: “Nuk është vijuar me përditësimin e procesit të regjistrimit të bazës së të dhënave SMIP në ARK, duke parashikuar qartësisht bazën ligjore, në kundërshtim me dispozitat e VKM nr. 945/2012, QSHA sqaron se një pretendim i tillë nuk qëndron. VKM nr. 742/2021 është në përputhje të plotë me VKM nr. 945/2012 dhe të gjitha këto akte janë propozuar dhe konsultuar me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë e tjerë dhe AKSHI-n, të cilat kanë dhënë miratimin për këtë akt.

Lidhur me pretendimet e mësipërme të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se, VKM nr. 742/2021 është akti i krijimit të bazës së të dhënave shtetërore SMIP, i cili njëkohësisht ngarkon QSHA si institucionin administrues të kësaj baze të dhënash. Për rrjedhojë, në kuptim të pikës 5, të nenit 3 të Ligjit, QSHA gëzon cilësinë e Kontrolluesit. Në cilësinë e Kontrolluesit dhe administratorit të sistemit, QSHA duhet të vijojë me përditësimin e bazës së të dhënave SMIP në ARK, duke parashikuar qartësisht bazën ligjore, si dhe çdo ndryshim tjetër, sipas dispozitave të neneve 9 dhe 11 të VKM nr. 945/2012. Regjistrimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave, ndër të tjera, është i nevojshëm për standardizimin dhe sigurinë e saj, me qëllim përcaktimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Lidhur me pretendimin se, “... të gjitha të dhënat që lidhen me të dhënat shtetërore të SMIP janë objekt i rregullimit të ligjit 69/2012, si kurrikula, institucionet arsimore, regjistrat, regjistrimet, transferimet, dëftesat dhe certifikatat, etj.”, Zyra e Komisionerit sqaron së pari se, konstatimi lidhet me bazën ligjore të përdorur për regjistrimin e SMIP në ARK. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, në pikën 1, të nenit 6 të tij, përcakton se të dhënat personale përpunohen për të përmbushur një detyrim ligjor të Kontrolluesit. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kuadrit ligjor, mbi të cilin Kontrolluesi pretendon se është mbështetur për regjistrimin e SMIP, si bazë e të dhënave shtetërore në ARK, rezulton se ngritja e këtij sistemi nuk mbështetet në një dispozitë ligjore konkrete në ligjin nr. 69/2012, por duhet mbështetur në VKM nr. 742/2021.

Në lidhje me konstatimin se: “Referuar kontratës nr. 565 prot., datë 04.02.2019 si dhe konstatimeve në vend, rezulton se SMIP ndërvepron me RKGJC dhe portalin e-Albania” pa pasur një dispozitë ligjore që të legjitimojë këtë ndërveprim.”, QSHA argumenton se: “Në pikën 6 të VKM nr. 742/2021, parashikohet se: “Sistemi SMIP ndërvepron me bazën e të dhënave shtetërore të RKGJC”, dhe në pikat 9 dhe 10 të kësaj VKM-je, parashikohet: SMIP është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave. Pra, konstatojmë se nuk ka asnjë shkelje të neneve 5 dhe 6 të Ligjit.”

Zyra e Komisionerit vlerëson se, si ligji nr. 69/2012, po ashtu edhe VKM nr. 742/2021, nuk e kanë të parashikuar ndërveprimin me portalin “e-Albania”, për identifikimin e përdoruesve administrativë, (konkretisht me “Modulin Qytetar”), në kundërshtim kjo me parimet dhe kriteret e neneve 5 dhe 6 të Ligjit.

Në lidhje me gjetjet e pikës 3 të procesverbalit, QSHA argumenton se: “SMIP është krijuar me VKM nr.742/2021, ku janë të parashikuara të gjitha institucionet për zbatimin e këtij vendimi. Në bazë të ligjit nr. 10325/2010 dhe VKM nr. 673/2017, AKSHI është institucioni përgjegjës për sigurinë e bazave të të dhënave shtetërore, që përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem në fushën TIK. Në bazë të VKM nr. 742/2021, të gjitha institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi duhet të marrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale. QSHA, në

zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 10325/2010 dhe pikës 9 të VKM nr. 742/2021, me urdhrin nr. 84, datë 22.09.2020, ka miratuar rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe bazës së të dhënave shtetërore”. Kjo rregullore është miratuar vetëm pas miratimit të AKSHI-t dhe reflektimit të të gjitha komenteve, ndërhyrjeve dhe sugjerimeve nga ana e tyre. Pra, konstatojmë së nuk ka asnjë shkelje të nenit 27 të ligjit nr. 9887/2008 dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në nenin 27 të Ligjit, QSHA në cilësinë e Kontrolluesit, duhet të garantojë marrjen e masave për sigurinë e të dhënave personale, konkretisht, duhet të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

QSHA, duhet të jetë në gjendje të demonstrojë kontrollin dhe të garantojë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, në mënyrë që përpunimi i tyre të kryhet vetëm në përputhje me udhëzimet e tij. Dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, në lidhje me aspektet e sigurisë së të dhënave, nuk përjashtojnë nga përgjegjësia ligjore Kontrolluesin, i cili ka detyrimin të demonstrojë përgjegjshmëri, si dhe të mbajë përgjegjësi, për realizimin e proceseve përpunuese, në përputhje me dispozitat e Ligjit.

Kontrolluesi, nuk mund të justifikojë anomalitë dhe cenimet eventuale në sigurinë e të dhënave, me faktin se për këtë qëllim është përgjegjës AKSHI, bazuar në dispozitat e VKM nr. 673/2017. Zyra e Komisionerit vlerëson se angazhimi i palëve të treta si Përpunues (qoftë edhe të përcaktuar me akt nënligjor), nuk çliron Kontrolluesin nga përgjegjësitë për të mbikëqyrur dhe monitoruar aspektet e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, që Kontrolluesi është i autorizuar t’i përpunojë dhe administrojë.

Në lidhje me gjetjet e pikës 4 të procesverbalit, QSHA argumenton se: *“Siç e kemi shpjeguar edhe më sipër SMIP është krijuar me VKM dhe ajo përcakton të gjitha parashikimet e mësipërme. Në pikën 7 të VKM-së parashikohet se të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin janë grumbulluar. Pra, VKM shteron të gjitha pyetjet e parashtruara. Siç është përmendur edhe në procesverbalin tuaj kontrata është lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe operatorëve ekonomikë dhe QSHA rezulton në cilësinë e përfituesit të shërbimit. Çdo lloj pasqyrimi në sistemin SMIP mund të bëhet vetëm nga AKSHI, i cili mund t’ia kërkojë një gjë të tillë kompanisë zhvilluese”.*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, faqja e internetit ku ngrihet platforma e SMIP <https://smip.al>, është krijuar me qëllimin e ushtrimit të detyrave funksionale të QSHA, dhe për pasojë, është Kontrolluesi ai që përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, si dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara sipas Ligjit. Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij

detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Në lidhje me gjetjet e pikës 5 të procesverbalit, QSHA argumenton se: *“QSHA dhe AKSHI në lidhje me bazat e të dhënave shtetërore duhet të zbatojnë me rigorozitet ligjin nr. 10325/2010, VKM nr. 945/2012 dhe VKM nr.673/2017. Në bazë të VKM nr. 673/2017, mirëmbajtja dhe hostimi i të gjitha bazave shtetërore është në kompetencë të AKSHI-t.”*, pra, konstatohet se nuk ka asnjë shkelje të nenit 20 të ligjit nr. 9887/2008 dhe Udhëzimit nr.19/2012 të Komisionerit.

Në lidhje me këtë pretendim, në vijim të qëndrimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet nuk qëndrojnë, pasi Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknike dhe organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit rithekson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që Përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e Përpunuesit, për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr.19 të Komisionerit.

Në lidhje me gjetjet e pikës 6 të procesverbalit, QSHA argumenton se: *“Lidhur me përmbajtjen e Njoftimit, do vlerësonim shumë sugjerimet e Komisionerit. Lidhur me sugjerimin e përfshirjes së rubrikës “minoritetit”, në rubrikën 4, gjejmë që nuk duhet të jetë një kategori e tillë dhe nuk mblidhet si e dhënë nga ana e QSHA. Komisioneri është autoriteti që shqyrton njoftimin dhe na njofton nëse është i pamjaftueshëm, duke përcaktuar edhe afatin kohor për plotësimin e tij. Pra, konstatohet se nuk ka asnjë shkelje të neneve 21 dhe 22 të Ligjit”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë, pasi nuk është detyrë e Zyrës së Komisionerit, të bëjë ndryshimin e gjendjes së njoftimit të Kontrolluesve. QSHA, në cilësinë e Kontrolluesit, i cili është në dijeni të vazhdueshme të proceseve të përpunimit që kryen, për shkak të ushtrimit të detyrave funksionale, mbart detyrimin për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave të njoftuar më parë, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit.

QSHA, në varësi të ushtrimit të funksioneve dhe proceseve të punës, duhet të njoftojë Komisionerin mbi përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Gjithashtu, është detyrë e Kontrolluesit që njoftimin duhet ta kryejë përpara se të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë, sipas nenit 22 të Ligjit. Ndryshimi i gjendjes së njoftimit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

Në lidhje me gjetjet e pikës 7 të procesverbalit QSHA argumenton se: *“Rregullorja është miratuar nga QSHA vetëm pas miratimit të përmbajtjes së saj nga ana e AKSHI-t. Në procesverbalin tuaj nuk citohen se referuar Ligjit, cilat janë proceset, procedurat dhe masat teknike e organizative që nuk parashikohen qartësisht. QSHA është e hapur që të reflektojë menjëherë sugjerimet Komisionerit, për plotësimin e rregullores me sugjerimet tuaja dhe dërgimin e tyre për shqyrtim drejt AKSHI-t si autoriteti përgjegjës, pra, konstatojmë se nuk ka asnjë shkelje të nenit 27 të Ligjit”.*

Lidhur me këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë dhe rriten se detyrimet e nenit 27 të Ligjit, rëndojnë mbi Kontrolluesin, i cili në rastin konkret është QSHA dhe jo AKSHI. Hartimi dhe zbatimi i një *“Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuadër të garantimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe garantimit të ligjshmërisë së përpunimit. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të Ligjit;
2. Kontrolluesi duhet të marrë masa dhe të ndjekë procedurën e parashikuar në Udhëzimin nr. 463, për përfshirjen e tij, në Aneksin 1 të këtij Udhëzimi;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave të përdoruesve, gjatë autentifikimit (identifikimit) përmes portalit “e-Albania”, në sistemin SMIP, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit, duke mundësuar një mënyrë që shmang përdorimin e llogarive personale të përdoruesve administrativë, të krijuara për një qëllim tjetër;
4. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje, zbatimin e detyrimeve, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave në faqen zyrtare www.smip.al dhe aplikacionet e regjistruara në “Play Store” dhe “App Store”;

5. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve, sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.19 të Komisionerit;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të “Njoftojë” Zyrën e Komisionerit, për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;
7. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, lidhur specifikisht me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen Kontrolluesi, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
8. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit;
9. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:
 - i. vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 6 më sipër;
 - ii. brenda këtij viti kalendarik, detyrimet e treguara në pikat 2 dhe 3 më sipër;
 - iii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 4;
 - iv. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 5 më sipër;
 - v. brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 7 dhe 8 më sipër.Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
10. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.
11. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit, nga një Kontrollues ose Përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 27.06.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi